



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe
Monitorimit

Data	
Nr.	Prot.

RELACION
PROJEKTVENDIM
PËR

“SHQYRTIMIN E RAPORTIT TË AUTORITETIT TË MEDIAS AUDIOVIZIVE TË PASQYRIMIT TË FUSHATËS ZGJEDHORE NGA OSHMA-TË PËR PERIU DHËN 23-30 PRILL 2023”

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Neni 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të ushtruar në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njuh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Neni 78, i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon të drejtat dhe detyrimet e subjekteve zgjedhore gjatë fushatës zgjedhore

Nenet 80 dhe 81, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikojnë rregullat e pasqyrit të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore dhe edicionet informative në radiotelevizionin publik.

Neni 83, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton se Këshilli Drejtues i Radiotelevizionit Publik jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve, cakton minutazhin në dispozicion të çdo partie, në bazë të dhënave të paraqitura nga KQZ-ja për partitë e regjistruara. Gjithashtu, ky këshill cakton nën mbikëqyrjen e KQZ-së, shortin për vendosjen e segmenteve orare për çdo parti të regjistruar.

Neni 84, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon se në fushatat zgjedhore në radiot dhe televizionet private, përcaktohet qartë se rregullat e pasqyrimin të fushatës zgjedhore, minutazhi politik, transmetimi i veprimtarive të institucioneve publike, qendrore ose vendore, pasqyrimi i veprimtarisë së partive joparlamentare, marrëdhënia me KQZ-në dhe kompetenca e KQZ-së për të urdhëruar entin rregullator për të proceduar me bllokimin e transmetimeve, në rast shkelje.

Neni 85, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar shprehet për monitorimin e fushatës zgjedhore në media, i cili kryhet nga enti rregullator, në këtë rast Autoriteti i Medias Audiovizive, të cilët në zbatim të paragrafit 4 kanë detyrimin të pasqyrojnë gjetjet e veta nga procesi i monitorimit në raporte të detajuara dhe t’ia paraqesin KQZ-së për kompetencë. Raportet shoqërohen sipas rastit me propozime për masa administrative.

Në raportin e dytë të dorëzuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vendimi nr. 33, datë 2.5.2023 i Autoritetit të Medias Audiovizive “Për shqyrtimin e raportit të mbulimit të fushatës zgjedhore nga oshma-të për periudhën 23-30 prill 2023”, vërejmë jo vetëm treguesit e monitoruar, por edhe propozimet përkatëse për marrjen e masave administrative. Raporti përmbledhës përmban të dhëna mbi:

- Depozitim në AMA të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA;
- Kohën e monitorimit të OSHMA-ve në monitorim, për transmetimet e lajmeve; hapësirën për çdo aktor politik;
- Kohën e monitorimit të OSHMA-ve në monitorim, për transmetimet e emisioneve;
- Reklamën politike ;
- Raportin gjinor të mbulimit mediatic të kandidatëve.

Në lidhje me treguesin “Depozitimi i regjistrimeve në AMA”, në pikën 6 të nenit 85 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcaktohet se: “Radiot dhe televizionet publike dhe private janë të detyruara të regjistrojnë të gjitha transmetimet e tyre përgjatë gjithë periudhës së fushatës zgjedhore. Këto regjistrime ruhen deri në mbarimin e 10 (dhjetë) muajve nga data e zgjedhjeve dhe vihen me kërkesë të KQZ-së menjëherë në dispozicion të saj”.

Detyrimi për depozitim e transmetimeve të çdo dite, parashikohet në metodologjinë e monitorimit të medias audio dhe audiovizive. Sipas tij, OSHMA-të vendore që nuk mbulohen nga mjetet monitoruese janë të detyruara të depozitojnë pranë AMA-s, përmbajtjen e transmetuar në fillim të çdo dite pasardhëse monitoruese.

Në bazë të vendimit nr. 33, datë 2.5.2023 të AMA-s, rezulton se 4 subjekte audiovizive, nuk kanë respektuar detyrimin ligjor të sipërcituar pasi nuk kanë depozituar regjistrime për

periudhën 23-30 prill 2023. Nga këto subjekte audiovizive 3 rezultojnë të mos kenë depozituar regjistrime që nga data 14-30 prill 2023.

AMA i propozon KQZ-së që për këto OSHMA të procedohet me marrje mase administrative, sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor.

Gjithashtu, AMA informon se 1 ofrues i shërbimeve mediatike dhe /ose audiovizive ka depozituar regjistrime jo për të gjitha ditët e kësaj periudhe.

AMA i propozon KQZ-së t'u tërheqë vëmendjen OSHMA-ve, për respektimin e plotë të këtij detyrimi.

Në lidhje me “të dhënat mbi edicionet informative”, pika 1, e nenit 81, të Kodit Zgjedhor, parashikon se në minutazhin politik të edicioneve informative, radiotelevizioni publik është i detyruar të zbatojë raporte kohore të barabarta për të gjitha partitë parlamentare, që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend.

AMA i propozon KQZ-së që OSHMA-të sipas mbulimit konkret që I kanë bërë fushatës për periudhën 14- 30 Prill 2023, të bëjnë në vijim kompensim në kohë transmetimi, në edicionet informative për efekt balancimi.

Në lidhje me treguesin “Reklamat politike”, në pikën 5 të nenit, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcaktohet se *“Koha e përgjithshme e transmetimit të reklamave politike gjatë gjithë fushatës zgjedhore nga secila radio dhe televizion privat nuk mund të jetë më shumë se 90 minuta për secilën parti të regjistruar për zgjedhje...”*

Në bazë të vendimit nr. 33, datë 2.5.2023 të AMA-s, rezulton se 1 subjekt audioviziv nuk e ka respektuar detyrimin ligjor të sipërcituar pasi ka tejkaluar kohën prej 90 minutash.

AMA i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ti kërkojë OSHMA-së ndërprerjen e transmetimit të reklamave politike përtej minutazhit të përcaktuar e të lejuar në Kodin Zgjedhor.

Në lidhje me treguesin “Reklamat politike”, në pikën 7 të nenit 84, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcaktohet se *“Reklamat politike të subjekteve zgjedhore transmetohen ndërmjet intervaleve kohore nga ora 15:00 deri 18:00 dhe nga ora 21:00 deri 24:00 të programit ditor.”*

Në bazë të vendimit nr. 33, datë 2.5.2023 të AMA-s, rezulton se 7 subjekte audiovizive, nuk kanë respektuar detyrimin ligjor të sipërcituar pasi kanë transmetuar reklama jashtë fashave orare të lejuara.

AMA i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve t'u kërkojë OSHMA-ve ndërprerjen e transmetimit të reklamave politike në kohën e ndaluar.

Sa i takon vlerësimin gjinor AMA i propozon KQZ-së ti tërheqë vëmendjen OSHMA-ve për të rritur nivelin e ndjeshmërisë ndaj kriterit të përfaqësimit gjinor në fushatën zgjedhore.

Pas verifikimeve përkatëse dhe dokumentacionit në tërësi, në lidhje me shqyrtimin e raportit të autoritetit të medias audiovizive të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 23.04.2023-30.04.2023, konstatoj se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 78, 80, 81, 83, 84 dhe 85 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në mbështetje të neneve të sipërcituara, si dhe nenit 19 të Kodit Zgjedhor, i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve miratimin e vendimit.

Valbona BALLGJINI	- Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe Monitorimit
Majlinda ÇELMETA	-Drejtor i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve
Ylli MERKAJ	- Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKT VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E RAPORTIT TË AUTORITETIT TË MEDIAS AUDIOVIZIVE TË PASQYRIMIT TË FUSHATËS ZGJEDHORE NGA OSHMA-TË PËR PERIUdhËN 23-30 PRILL 2023

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 78, 80, 81, 83, 84 dhe 85, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr.2, datë 30.01.2021 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive”

VËREN:

Pika 6 e tenit 85, të Kodit Zgjedhor, përcakton se radiot dhe televizionet publike dhe private janë të detyruara të regjistrojnë të gjitha transmetimet e tyre përgjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Këto regjistrime ruhen deri në mbarimin e dhjetë muajve nga data e zgjedhjeve dhe vihen, me kërkesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ-së), menjëherë në dispozicion të saj.

Neni 8 i vendimit nr. 2, datë 30.01.2021, i Komisionit Rregullator, “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive” parashikon se OSHMA-t vendore që nuk mbulohen nga mjetet monitoruese janë të detyruara të depozitojnë pranë AMA-s, përmbajtjen e transmetuar në fillim të çdo dite pasardhëse monitoruese”.

Referuar vendimit nr.33, datë 2.5.2023 të AMA-s “Për shqyrtimin e raportit të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 23-30 prill 2023”, konstatohet si vijon:

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456
Ora: hh:mm



Për shqyrtimin e raportit të autoritetit të medias audiovizive të pasqyrit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 14-22 Prill 2023

I. Depozitimi i regjistrimeve në AMA

1. Subjektet audiovizivë të cilët nuk kanë paraqitur regjistrimet pranë AMA-s nga data 23 deri në datë 30 prill 2023 janë OSHMA-të:

- Gold TV
- Channel 7
- TV 1 Channel
- Saranda TV

AMA i propozon KQZ-së që për këto OSHMA të procedohet me marrje masë administrative sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor.

Gold TV, Channel 7 dhe Saranda TV rezultojnë të mos kenë depozituar regjistrime pranë AMA-s nga data 14-30 prill 2023.

2. Subjektet audiovizivë të cilët kanë depozituar regjistrime jo për të gjitha ditët e kësaj periudhe janë OSHMA-të:

- TV Klaudiana (nuk i ka depozituar për datat 28-30 Prill)

AMA i propozon KQZ-së t'u tërheqë vëmendjen OSHMA-ve, për respektimin e plotë të këtij detyrimi.

II. Të dhëna mbi edicionet informative

Pika 1, e nenit 81, të Kodi Zgjedhor, parashikon se në minutazhin politik të edicioneve informative, radiotelevizioni publik është i detyruar të zbatojë raporte kohore të barabarta për të gjitha partitë parlamentare, që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend. Partitë që kanë marrë më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend, përfitojnë kohë transmetimi të shpërndarë në mënyrë të barabartë midis tyre. Secila nga këto parti përfiton kohë sa dyfishi i kohës që përfiton një parti që ka marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend. I njëjti parashikim zbatohet edhe për OSHMA-të private.

AMA i propozon KQZ-së që OSHMA-të sipas mbulimit konkret që I kanë bërë fushatës për periudhën 14- 30 Prill 2023, të bëjnë në vijim kompensim në kohë transmetimi, në edicionet informative për efekt balancimi.

III. Të dhëna mbi reklamat politike

Referuar pikave 4, 5 dhe 7 të nenit 84 , të Kodit Zgjedhor, parashikohen kriteret ligjore për transmetimin e reklamës politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Pika 4 e nenit 84 parashikon *“Vetëm subjektet zgjedhore të regjistruara për zgjedhje kanë të drejtë të transmetojnë reklama politike gjatë periudhës zgjedhore në radiot, televizionet apo mediat audiovizive private, qofshin këto numerike, kabllore, analoge, satelitore apo të çdo lloj forme dhe mënyre të transmetimit të sinjalit. Reklammat politike të koalicioneve zgjedhore llogariten brenda kohës së partive politike anëtare të koalicionit, sipas marrëveshjes individuale të secilës parti me operatorin radioteleviziv. Reklama politike duhet të identifikojë qartë subjektin porositës. Në rast se reklama politike nuk është identifikuar qartë, KQZ-ja urdhëron pezullimin e menjëhershëm të transmetimit të saj derisa të bëhet identifikimi i kërkuar nga kjo pikë.”*

Pika 5 e nenit 84 parashikon *“Koha e përgjithshme e transmetimit të reklamave politike gjatë gjithë fushatës zgjedhore nga secila radio dhe televizion privat nuk mund të jetë më shumë se 90 minuta për secilën parti të regjistruar për zgjedhje...”*

Pika 7 e nenit 84 parashikon *“Reklammat politike të subjekteve zgjedhore transmetohen ndërmjet intervaleve kohore nga ora 15:00 deri 18:00 dhe nga ora 21:00 deri 24:00 të programit ditor.”*

1. OSHMA-ja Shijak TV ka tejkaluar kohën prej 90 minutash për njërin prej subjekteve zgjedhore konkruese (145.55 minuta)

AMA i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ti kërkojë OSHMA-së ndërprerjen e transmetimit të reklamave politike përtej minutazhit të përcaktuar e të lejuar në Kodin Zgjedhor.

2. OSHMA-të të cilat kanë transmetuar reklama politike jashtë kohës së përcaktuar nga Kodi Zgjedhor janë:

-RTSH Gjirokastra ka transmetuar reklama jashtë fashës orare të lejuar për datat:

28 Prill 2023 (14:03; 14:54; 18:50; 19:30)

- Shijak TV ka transmetuar reklama jashtë fashës orare të lejuar për datat:

24 prill 2023 (08:24; 08:26; 08: 40; 08:46; 08:59)

25 Prill 2023 (08:42; 08:47; 08:49; 13:53)

26 Prill 2023 (08:40; 08:45; 08:52; 09:00)

27 Prill 2023 (08:09; 08:11; 08:13; 08:37; 08:38; 08:40; 08:41; 08:49)

28 Prill 2023 (08:21; 08:32; 08:36; 08:42; 08:49)

29 Prill 2023 (08:17, 08:21, 08:23, 08:25, 08:53, 20:47, 20:51)

30 Prill 2023 (14:30, 14:37, 19:56, 19:59, 20:30, 20:35, 20:41)

- Klan Plus TV ka transmetuar reklama jashtë fashës orare të lejuar për datat

26 Prill (12:32)

- Vizion Plus ka transmetuar reklama jashtë fashës orare të lejuar për datat

28 Prill 2023 (18:17)

- Fax News ka transmetuar reklama jashtë fashës orare të lejuar për datat

29 Prill 2023 (14:01)

- Bulevard TV ka transmetuar reklama jashtë fashës orare të lejuar për datat

28 Prill 2023 (08:02; 09:29; 09:58; 12:02; 13:56; 19:24; 19:56; 20:20)

29 Prill 2023 (11:01)

- Top Channel ka transmetuar reklama jashtë fashës orare të lejuar për datat

30 Prill 2023 (18:17, 18:51)

AMA i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve t'u kërkojë OSHMA-ve ndërprerjen e transmetimit të reklamave politike në kohën e ndaluar.

IV. Raporti i përfaqësimit gjinor në fushatë

AMA i propozon KQZ-së ti tërheqë vëmendjen OSHMA-ve për të rritur nivelin e ndjeshmërisë ndaj kriterit të përfaqësimit gjinor në fushatën zgjedhore.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI